



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimin kapital të disa aseteve të Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimin kapital të disa asetëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje të gjithëve!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 7 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni në këtë rend dite janë 11 çështje, të cilat jua kemi vënë në dijeni.

Jeni dakord me këto çështje?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Kalojmë pa humbur kohë në çështjen e parë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e një projektvendimi “Për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimin kapital të disa asetëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Bashkë me ne është edhe Luljeta e cila do t’jua relatojë këtë projekt-akt të miratuar nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit.

*Luljeta Laze:* Përshëndetje të gjithëve!

Procesi i transferimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aseteve është një proces që ka filluar që në muajin korrik dhe meqenëse këtë proces e ka ndjekur nga afër Xhevdeti, do ta relatojë ai.

***Xhevdet Haxhiu:*** Përshëndetje të gjithëve!

Atëherë, siç e tha edhe Drejtoresha, në muajin korrik, në vijim të procedurës së ndjekur në muajin korrik të nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimit të disa aktiveve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për tek institucioni i ILD-së, Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka vazhduar me vlerësimin e aktiveve të tjera që janë në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Procedura e vlerësimit të këtyre aktiveve është zhvilluar bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrisë së Financave dhe Urdhrit nr. 101, datë 14.07.2020 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e disa aktiveve, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Kjo procedurë u zhvillua bazuar në rezultatet e inventarit periodik të aktiveve, për vitin ushtrimor 2019, si dhe duke marrë edhe shkas nga transferimi që filloi dhe bë menjëherë pas muajit korrik-gusht të institucionit të KLGJ-së për tek godina ku ne jemi sot.

Ky Komision e zhvilloi vlerësimin duke u bazuar në listën e përgatitur nga nëpunësi i parë i autorizuar duke u mbështetur në të gjithë të dhënat dhe të gjithë elementët kontabël të një aktive, në vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto përfitim.

Dua të theksoj që të gjithë aktivet të cilat janë përfshirë në procesin e vlerësimit, nga komisioni, janë përdorur minimum 10 vjet nga koha e vënies së tyre në punë dhe shumica i përkasin institucioneve të ish-KLD-së dhe ish-ZABGJ-së). Pjesa më e madhe e këtyre aseteve janë pajisje të IT-së (kompjuterat, printerat, UPS, fotokopje, pajisje të tjera teknike), koha e përdorimit të cilave është 11 vjet e sipër, dhe kanë një vlerë shumë të madhe të akumuluar amortizimi.

Kështu që, Komisioni, duke marrë shkas dhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave 506 për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-godina ku ishte vendosur KLGJ-ja, ka vlerësuar për disa asete që janë në gjendje të mirë, pavarësisht se kanë një kohë shumë të gjatë shfrytëzimi, janë në gjendje të mirë dhe mund të përdoren, si dhe ato janë pjesë funksionale dhe pjesë integrale e godinës së vjetër.

Kështu që këto aktive ne i kemi vlerësuar si të panevojshme për Këshillin dhe sugjerojmë transferimin e tyre pa pagesë pranë Institucionit të Departamentit të Administratës Publike. Aktivet janë radhitur sipas Pasqyrës nr. 1 që është bashkëlidhur relacionit.

Gjithashtu Komisioni verifikoi edhe aktive të tjera, duke vlerësuar se për këto aktive, duke u nisur nga koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, riparimi i tyre është i pamundur si pasojë e konsumit dhe nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër, si dhe vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është jo efiçente sipas parimit kosto përfitim. Kosto është shumë e lartë dhe nuk arrihet të bëhet një riparim i tillë.

Këto aktive janë evidentuar të grupuar sipas natyrës së tyre, në Pasqyrën nr. 2 që ju e keni bashkëlidhur.

Për sa më sipër, bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrisë së Financave, i ndryshuar, vlerësojmë shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit, si më poshtë:

Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve sipas pasqyrave nr. 1 pranë Departamentit të Administratës Publike.

Si dhe miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit sipas pasqyrës nr. 2 duke u ndjekur procedurat e tjera nga Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi, sipas ligjeve në fuqi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve sipas pasqyrave nr. 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimin.

2. Transferimin pa pagesë të aktiveve, të listuara në pasqyrën nr.1, pranë Departamentit të Administratës Publike, institucion i cili ka marrë në përgjegjësi administrimi ish-godinën e KLGJ-së në adresën “Bulevardi “Zog i I-rë”, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 24.06.2020.

3. Nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, të listuara në pasqyrën nr.2, sipas rregullave të përcaktuara.

4. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale (investime), në programin buxhetor “Buxheti i gjykatave””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale (investime), në programin buxhetor “Buxheti i gjykatave””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale (investime), në programin buxhetor “Buxheti i gjykatave”. Sërish ia jap fjalën zonjës Laze.

*Luljeta Laze:* Faleminderit!

Në vijim të punës së përvitshme ka rezultuar e nevojshme rialokimi i fondeve në investime në programin buxhetor “Buxheti i gjykatave”, konkretisht janë verifikuar dy grup nevojash: Së pari, Gjykata e Lartë me shkresën e saj datë 18.09.2020 kërkon rialokim të fondeve të miratuara në buxhetin për investime. Gjykata ka konstatuar disa problematika, “në lidhje me kriteret dhe procedurat për garantimin e rregullit dhe të

sigurisë në gjykatë”. Konkretisht ajo kërkon të realizojë vendosjen e një dere dedektimi, hyrje me akses të kontrolluar, sistem alarmi për ruajtjen e perimetrit nga keqbërësit, sistem sinjalizim zjarri për të gjithë godinën. Për zgjidhjen e kësaj problematike kërkon që të rialokojë fondet e veta të pa përdorura në zërat “Rikonstruksion” dhe “Projekt” në zërin pajisje, të cilat alokuar në fillim të vitit për këtë gjykatë.

Fondet e parashikuara në zërin “Rikonstruksion” vlera 1 milion lekë, u programuan për eliminimin e pasojave të tërmetit. Gjykata ka operuar me shpenzimet operative duke qenë se kjo ka qenë një emergjencë dhe e ka trajtuar këtë në zërin “mirëmbajtje”. Në këto kushte, ky fond ka mbetur i papërdorur.

Gjithashtu edhe në zërin “Projekt” gjykata kishte vlerësuar që ishte e nevojshme 300 mijë lekë për hartimin e projektit për rikonstruksionin e dhomës së serverit. Rikonstruksioni i dhomës së serverit është i nevojshëm dhe është një detyrë e lënë nga AKSH-i për të gjitha institucionet dhe ka standarde sesi do të realizohet.

Nga ana tjetër, gjithashtu ky fond deri tani nuk është përdorur, pasi AKSH-i ka marrë përsipër që t’ia u realizojë këtë projekt Gjykatës së Lartë, kështu që këto fonde nuk përdoren. Pikërisht këto dy fonde që nuk janë përdorur, gjykata, në vlerësim të atyre nevojave të parashtruara si më sipër, kërkon që t’i transferojë në zërin “Pajisje”, në mënyrë që të realizojë nevojat që ajo ka, brenda investimeve të fondeve të veta.

Gjithashtu është vlerësuar i nevojshëm edhe rialokimi për katër gjykata të tjera në zërin “Rikonstruksion”, në zërin “Pajisje”, dhe këto secila brenda fondeve të veta.

Në fillim të vitit për katër gjykata është alokuar fond në zbatim të objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Drejtësisë për të Mitur, (Plani i veprimit 2018 – 2021), ishin parashikuar fonde për krijimin e ambientit miqësor për të miturit, që janë në konflikt me ligjin. U parashikuan 4 gjykata, duke marrë parasysh disa kritere, pra të ishin gjykata që do e kishin të mundur, pra kishin hapësirat e nevojshme, të kishin të mundur një ambient ku të vendoseshin këto, por gjithashtu në fillim kur janë alokuar fondet ka qenë e paqartë mënyra se si do të realizohej kjo gjë dhe menduam që këto i kemi alokuar në rikonstruksion. Përgatitja e këtyre ambienteve, me kalimin e kohës jemi saktësuar edhe me ndihmën që kemi pasur nga Projekti “Justice for All”, pasi ata po modelojnë një ambient të tillë në Gjykatën e Tiranës dhe pikërisht këtë modelim që ata kanë përdorur,



tashmë besoj që mund ta trajtojmë edhe në këto 4 gjykata që neve kemi vendosur dhe qëllimi i krijimit të këtij ambienti miqësor për të mitur në konflikt me ligjin, është krijimi i një salle gjyqi që të jetë më pak imponuese sesa sallat tradicionale, por që në të njëjtën kohë të ruajë solemnitetin dhe dinjitetin e gjykatës. Kështu që, e gjithë ideja transferohet në krijimin e disa pajisjeve në këtë ambient, pajisje që sikurse thashë, i kemi marrë sipas modelit që po trajton “Justice for All” tek Gjykata e Tiranës.

Pra në fund të fundit del e nevojshme që këto fonde i rialokuem fillimisht kur nuk e kishim të qartë, kishim të qartë nevojën e krijimit të ambientit, por jo se si do të realizohej ai, nga “rikonstruksion”, t’i kalojmë në “pajisje”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit Luli!

Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit?

**Alban Toro:** Nëse mundem?

Atëherë, jo se kam gjë kundër vlerës së sjellë, sepse kam biseduar me detaje me Lulin, por do dëshiroja një informacion, ndoshta nga personi i ngarkuar, në lidhje me gjendjen e sigurisë në gjykata dhe në ç’gjëndje është infrastruktura e sigurisë në gjykata sepse mbase do na duhet si Këshill të marrim vendimmarrje të tjera për ta modernizuar këtë sistem sigurie në gjykata dhe pse jo të caktojmë në burimet tona njerëzore një person me njohuri të posaçme i cili të kryejë edhe këtë modernizim, kështu që informacion të nevojshëm për të ditur se si është sistemi i sigurisë në gjykata, që në opinionin tim është jashtëzakonisht i degraduar dhe cilat janë masat që duhet të marrë Këshilli në të ardhmen, ndoshta në diskutimin që do bëjmë në projektbuxhetin e ardhshëm (vitin që vjen), për ta modernizuar këtë sistem sigurie duke përbushur kështu një detyrim thelbësor ndaj gjyqtarëve. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Luli ke gjë për të shtuar?

**Luljeta Laze:** Po, kam!

Besoj që kjo mund të jetë për një mbledhje të ardhshme, kjo kërkesë. Por unë do të thoja që tani që ka një informacion të bollshëm. Unë e kam theksuar edhe më përpara.

Në fakt, për gjykatat ne nuk kemi një sistem të plotë të integruar, të qartë për sigurinë e tyre, por kemi elementë të sigurisë së gjykatave, në të gjitha gjykatat. Informacioni se cili nga elementët ka të garantuar se cila prej gjykatave, e kemi të hollësishëm dhe mund t'ua vëmë në dispozicion.

Sigurisht është shumë e rëndësishme ajo që të ketë një person përgjegjës, ndoshta edhe pas daljes së vendimit të qeverisë Për sigurinë dhe ruajtjen e gjykatave, dhe besoj që është diskutuar dhe është përgatitur më duket edhe një urdhër që kjo detyrë t'i ngarkohet edhe këtu brenda KLGJ-së një personi, i cili do të jetë përgjegjës.

**Naureda Llagami:** Këtë doja të shtoja unë Luli, që janë caktuar dy persona përgjegjës lidhur me sigurimin e gjykatave pranë KLGJ-së, të cilët marrin informacion dhe bëjnë edhe administrimin e informacionit dhe koordinojnë punën në të gjithë gjykatat.

**Luljeta Laze:** Dhe këtyre dy personave ne mund t'i vëmë në dispozicion të gjithë informacionin që kemi. Sigurisht që ky informacion që ne kemi, edhe do të modifikohet më pas me hartën e re gjyqësore dhe besoj që çfarë pajisjesh janë për sigurinë dhe çfarë duhet të shtohen, do jetë pjesë edhe e studimeve të mëtejshme dhe alokimi i fondeve sipas nevojave që do rezultojnë. Faleminderit!

**Alban Toro:** Thjesht një pyetje për kuriozitet.

Formimi profesional i këtyre personave që merren me këtë çështje, -çfarë profesioni?

**Naureda Llagami:** Këto dy persona janë në nivel përgjegjës sektori dhe specialist pranë Drejtorisë së Administrimit të Buxhetit.

**Alban Toro:** Profesinin, pyeta.

Janë ushtarakë? Kanë mbaruar shkollën e policisë?

Cili është profesioni?

**Naureda Llagami:** Në administratën tonë ne nuk kemi njerëz që kanë formime të tilla. Këto persona që kemi përcaktuar këtu në administratën tonë, janë persona që përfshihen tek Drejtoria e administrimit të gjykatave, koordinojnë punën, marrin

informacionin, e përpunojnë dhe reflektojnë nevojat që ka secila gjykatë mbi problematikat e sigurisë.

**Alban Toro:** Unë prandaj insistova tek informacioni për në mbledhjet në vijim, pasi do të na duhet të marrim vendime që në strukturën tonë të ketë persona që kanë mbaruar këtë profesion (ushtarak ose në shkollën e policisë), pasi aftësitë dhe profesioni që zotërojnë në këtë fushë, do të na duhet ta përdorim për të modernizuar sistemin e sigurisë së gjykatave, që e përsëris, në opinionin tim është i degraduar. Kështu që në këto kushte mendoj që të japim një kontribut sado të vogël, qoftë me personel apo edhe me burime financiare të nevojshme për ta modernizuar këtë sistem. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Alban!

Do ta mbajmë parasysh që ta konsiderojmë këtë propozim.

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e rishpërndarjes së fondeve, sipas nevojave të disa gjykatave, në artikullin shpenzime kapitale (investime), në programin “Buxheti i gjykatave”, si më poshtë:

- Gjykata e Lartë, pakësohet në nënartikullin “Projekte” në shumën 300,000 lekë dhe në nënartikullin “Rikonstruksione” në shumën 1,000,000 lekë dhe shtohet në nënartikullin “Orendi dhe pajisje zyre” në shumën 1,300,000 lekë.

-Gjykata e Apelit Shkodër, pakësohet në nënartikullin “Rikonstruksione” në shumën 200,000 lekë, dhe shtohet nënartikullin “Orendi dhe pajisje zyre” në shumën 200,000 lekë.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pakësohet në nënartikullin “Rikonstruksione” në shumën 200,000 lekë, dhe shtohet nënartikullin “Orendi dhe pajisje zyre” në shumën 200,000 lekë.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, pakësohet në nënartikullin “Rikonstruksione” në shumën 200,000 lekë, dhe duke shtuar nënartikullin “Orendi dhe pajisje zyre” në shumën 200,000 lekë.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pakësohet në nënartikullin “Rikonstruksione” në shumën 200,000 lekë, dhe shtohet në nënartikullin “Orendi dhe pajisje zyre” në shumën 200,000 lekë.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisht nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Alban, ndoshta ti nuk duhet të jesh këtu.

**Alban Toro:** Po, po! Sa doja të ndërhyrja.

Për pikën 3 dhe 4 bën pjesë për procedurat e ngritjes në detyrë të pozicionit të shpallur me vendimin nr. 87. Për këtë procedurë kam dhënë dorëheqjen. Kështu që po pres të më thërrisni për pikën 5 dhe më tutje. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Shehu!

**Marçela Shehu:** Kandidatja znj. {...}, ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020. më herët zonja {...} ka kandiduar edhe për dy pozicione të tjera të lira në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020 të Këshillit. Për këto pozicione është bërë më herët verifikimi i kriterëve formale të zonjës {...}. Ky relacion dhe ky projektvendim trajton vetëm verifikimin e kriterëve formale për kandidimin e zonjës {...} vetëm për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 87.

Edhe për këtë pozicion, pas verifikimit të kryer rezulton se zonja {...} i përmbush kriteret. Ajo rezulton të ketë përvojë të përgjithshme profesionale mbi 13 vjet si gjyqtare. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e të drejtës civile. Zonja {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi si dhe nuk paraqiten problematika lidhur me papajtueshmërinë ambientale.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores, pas konfirmimit nga Komisioni të zhvillimit të plotë të procedurës së verifikimit, i propozoj Këshillit verifikimin e plotësimit nga kandidatja të këtyre kriterëve që përmenda. Ju faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

*Maksim Qoku*: Pro.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika e 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e kritereve ligjore për znj. {...}. Relator për këtë projekt-akt është z. Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Zonja {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ka filluar

procedura e verifikimit sa i përket plotësimit nga kandidatja të kriterëve të kandidimit për këtë pozicion të lirë. Ndërkohë, më herët, kandidatja ka kandiduar edhe për dy pozicione të lira po në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. Procedura e verifikimit për kandidimin në këto dy pozicione ka filluar që më herët, fillimisht me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020. Në këtë rast, për këto dy kandidime, për zonjën {...} është verifikuar plotësimi i tre kriterëve formale të kandidimit, pra “përvoja profesionale minimale”, “mospasja e masës disiplinore në fuqi” dhe “papajtueshmëria ambientale”. Këshilli ka vendosur që kandidatja i plotëson këto kriterë me vendimin e tij nr. 235, datë 02.07.2020.

Në këto kushte, sa kohë që kandidatja ka kandiduar edhe për pozicionin e tretë të lirë të shpallur në fushën e së drejtës civile, Këshilli do duhet të verifikojë plotësimin e të njëjtave kriterë, pra të tre kriterëve formale, edhe sa i përket kandidimit të zonjës {...} për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

Ndërsa janë verifikuar më herët këto tre kriterë formale, ndërkohë që nga verifikimi, sa i përket kandidimit për pozicionin e tretë të lirë, pra atë të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, nuk është verifikuar ndonjë e dhënë që të çon në mosplotësimin e ndonjërit prej këtyre tre kriterëve formale, unë si relator i çështjes i propozoj Këshillit që të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nga kolegët, kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në procedurën e votimit, sipas propozimit të bërë nga relatori dhe Komisioni?

**Maksim Qoku:** Kundër, në lidhje me qëndrimin e mëparshëm të mbajtur ndaj këtij magjistrati për pozicionin në fjalë.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër, për shkak të qëndrimit të mbajtur edhe më parë. Kam vlerësuar që nuk plotëson përvojën specifike që kërkohet për këtë pozicion, pasi 5 vitet e kërkuara në fushën e së drejtës civile, i ka para 13 viteve të fundit. Ndërkohë, për pjesën e ndihmësgjyqtarit jam shprehur që përfshihet në përvojë profesionale.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

5.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”;

5.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”;

5.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

5.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”;

5.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”;

5.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

*Naureda Llagami:* Para se të kalojmë tek çështja e 5 të rendit të ditës, stafi të më mundësojë që zoti Toro të jetë prapë në linjë.

*Alban Toro:* Jam në linjë.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në shqyrtimin e pikës 5 të rendit të ditës, e cila ka tre çështje në fakt. Për më shumë detaje, ia jap fjalën zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime, njëri është “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”; një projektvendim tjetër “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”; projektvendimi tjetër është “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

Për të tre projektvendimet është përgatitur një relacion dhe shkurtimisht mund t’ju them që Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, më datë 28.05.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në disa gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to edhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.175, në Gjykatën e Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale sipas Vendimit nr.177, dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.178.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë përfundoi më datë 15.06.2020 dhe brenda këtij afati nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë, ndërsa vijonte të ekzistonte nevoja për plotësimin e tyre, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave. Konkretisht me Vendimin nr. 227, datë 02.07.2020, me vendimin nr. 228, datë 02.07.2020 dhe me vendimin nr. 229, datë 02.07.2020.

Në të tre këto procedura ngritjeje në detyrë, afati i kandidimit u përcaktua i njëjti, konkretisht “dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë”.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë përfundoi më datë 19.07.2020 dhe brenda këtij afati përsëri nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre tre gjykatave. Konkretisht me Vendimin nr. 300, nr. 299 dhe nr. 298 të datës datë 10.09.2020.

Edhe në këtë rast, për të tre procedurat e ngritjes në detyrë, u përcaktua i njëjti afat kandidimi, konkretisht “dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë”.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë përfundoi më datë 24.09.2020 dhe brenda këtij afati përsëri nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Ndërsa në Gjykatat e Apelit Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër, vijojnë të ekzistojnë pozicionet e lira në fushat përkatëse të së drejtës si më lart, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimet për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në këto tre gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë të strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtjeje si dhe në rastin e hapjes dhe të rihapjes së këtyre procedurave të ngritjes në detyrë, me përjashtim të afatit të kandidimit, i cili është përcaktuar “deri më datë 23.10.2020”, sikundër ky afat është propozuar edhe për hapjen rishtazi të gjashtë



procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Ky afat është gati dyjavor, pra që është minimumi që përcakton ligji.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me tre projekt-aktet e propozuara?

Nëse jo, kalojmë në projekt-aktin e parë në votim që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile dhe me një afat kandidimi 23 tetor 2020.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, projekt-akti u miratua sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale. Dhe për këtë, afati i kandidimit është data 23 tetor 2020.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të Komisionit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile. Dhe për këtë, afati i kandidimit është data 23 tetor 2020.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të Komisionit.

\* \* \*

(Pika e 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 6 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

6.1 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.2 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

6.3 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.4 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.5 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

6.6 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Brunilda Kadi** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Illir Toska** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
10. **Marçela Shehu** (anëtare)
11. **Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
4. **Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
5. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
6. **Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
7. **Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
8. **Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të USAID.**

## **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i 6 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

6.1 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.2 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

6.3 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.4 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

6.5 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

6.6 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë edhe kjo me shqyrtimin e 6 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do relatohen nga zoti Ilir Toska, për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit. Fjala sërish për zotin Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur 6 projektvendime për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë për një pozicion në Gjykatën e Apelit Durrës, për tre pozicione në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe për një pozicion në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për të gjashtë këto projektvendime është përgatitur edhe relacioni që është shpërndarë. Lidhur me këto, mund të them se Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, më datë 28 maj 2020 hapi procedurat e ngritjes në detyrë në gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nëpërmjet vendimeve nr. 173 – nr. 176. Janë 14 pozicione të lira që janë hapur për këto procedura. Vetëm për 11 pozicione të lira ka pasur kandidime nga ana e gjyqtarëve dhe janë në proces verifikimi.

Vlen të përmendet se në tre procedura ngritjeje në detyrë, konkretisht: në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër, nuk pati kandidime për pozicionet e lira të shpallura për këto gjykata. Për këtë shkak, Këshilli ka shpallur dhe rishpallur, siç përmenda pak më herët, disa herë procedurat e ngritjes në detyrë në këto gjykata.

Ndërkohë, njëmbëdhjetë pozicionet e lira për të cilat ka pasur kandidime për ngritjen në detyrë, ato i përkasin Gjykatës së Apelit Durrës (2 pozicione, 1 në fushën e të drejtës civile/1 në fushën e të drejtës penale), Gjykatës së Apelit Korçë (1 pozicion në fushën e të drejtës civile), Gjykatës së Apelit Tiranë (7 pozicione/5 në fushën e të drejtës civile dhe 2 në fushën e të drejtës penale) dhe Gjykatës së Apelit Vlorë (1 pozicion në fushën e të drejtës civile).

Pavarësisht hapjes së procedurave si më sipër për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, në kushtet kur këto procedura nuk janë përmbyllur ende, vijon të ekzistojë e njëjta situatë emergjente për plotësimin e vakancave, ndërsa janë krijuar dhe vakanca të reja të përhershme, por edhe vakanca të përkohshme, si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar. Po ashtu, është krijuar vakancë e re e përhershme edhe në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Konkretisht, mbas hapjes së dy procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, në këtë gjykatë është krijuar edhe një pozicion i lirë i përhershëm që lidhet me pozicionin e mbajtur më parë nga gjyqtari {...} Ky i fundit, me Vendimin nr. 111, datë 27.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shkarkuar nga detyra, vendim i cili, pas ankimit të tij, është lënë në fuqi me Vendimin e datës 09.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në Gjykatën e Apelit Shkodër, mbas hapjes së një procedure ngritjeje në detyrë, në këtë gjykatë është krijuar edhe një pozicion i lirë i përhershëm që lidhet me pozicionin e mbajtur më parë nga gjyqtari Luan Dervishi. Ky i fundit, me Vendimin nr. 83, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shkarkuar nga detyra, vendim i cili, pas ankimit të tij, është lënë në fuqi me Vendimin e datës 01.10.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbas hapjes së shtatë procedurave të ngritjes në detyrë, janë krijuar edhe tre pozicione të lira të përhershme, që lidhen me pozicionet e mbajtura më parë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}. Rezulton se:

1. Gjyqtari {...} është shkarkuar nga detyra me Vendimin nr. 108, datë 15.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim i cili, pas ankimimit të tij, është lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me Vendimin e datës 13.07.2020.
2. Gjyqtari {...} ka paraqitur kërkesë për dorëheqje, mbi të cilën, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 264, datë 30.07.2020, ka vendosur: “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Gjin Gjoni...”.
3. Gjyqtari {...} ka paraqitur kërkesën për dorëheqje, mbi të cilën, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 265, datë 30.07.2020, ka vendosur: “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}...”.

Ndërsa, në Gjykatën e Apelit Vlorë, mbas hapjes së një procedure ngritjeje në detyrë , në këtë gjykatë është krijuar edhe një pozicion i lirë i përhershëm që lidhet me pozicionin e mbajtur më parë përkohësisht nga gjyqtari {...}. Ky i fundit, me Vendimin nr. 136, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shkarkuar nga detyra, vendim i cili, pas ankimimit të tij, është lënë në fuqi me Vendimin e datës 16.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Vlen të përmendet se në Gjykatën e Apelit Durrës aktualisht janë në detyrë vetëm katër gjyqtarë, nga trembëdhjetë të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Pesë nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak të Ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira. Një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate është pezulluar për shkak të ndjekjes penale, ndërsa së fundi, me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ai është deklaruar fajtor dhe dënuar penalisht për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, duke iu dhënë si dënim plotësues heqja e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për një periudhë 3-vjeçare, dënim plotësues që ende nuk është ekzekutuar.

Në Gjykatën e Apelit Shkodër aktualisht janë në detyrë vetëm tre gjyqtarë, nga dhjetë të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Pesë nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak



të Ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë aktualisht janë në detyrë vetëm dymbëdhjetë gjyqtarë, nga tridhjetë e një të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Gjashtë nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak të Ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira. Një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, jam unë, është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, shkak për të cilin është pezulluar ushtrimi i funksionit tim si gjyqtar. Një tjetër gjyqtari të kësaj gjykate i është dhënë leje e papaguar dyvjeçare nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, afati i të cilës ka përfunduar, ndërsa ky gjyqtar më herët ka njoftuar Këshillin për pamundësinë e paraqitjes në detyrë si rezultat i pamundësisë së udhëtimit si pasojë e masave të marra, nga shteti ku ndodhej, për ndërprerjen e përhapjes së Covid-19. Ky njoftim i është përcjellë për trajtim drejtuesit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Deri më sot nga gjykata nuk ka njoftim për paraqitjen në detyrë të këtij gjyqtari. Për një gjyqtar tjetër të kësaj gjykate, me vendim gjyqësor penal të formës së prerë të datës 27.02.2019, ndër të tjera, është vendosur dhe heqja e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për shkak të dënimit penal për kryerjen e një veprë të rëndë penale, dënim plotësues ky që është ekzekutuar, ndërsa Këshilli është në shqyrtim e sipër të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe masën e shkarkimit nga detyra të propozuar prej tij.

Ndërsa në Gjykatën e Apelit Vlorë aktualisht janë në detyrë vetëm gjashtë gjyqtarë, nga dymbëdhjetë të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Tre nga gjyqtarët e kësaj gjykate janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe janë pezulluar nga detyra për shkak të Ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë pozicionet e mbajtura nga ata përkohësisht të lira. Një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor (zonja Ukperaj) shkak për të cilin është pezulluar ushtrimi i funksionit të gjyqtarit.

Sa i përket pozicioneve të lira të krijuara rishtazi si më sipër në Gjykatën e Apelit Durrës (1 pozicion), në Gjykatën e Apelit Shkodër (1 pozicion), në Gjykatën e Apelit Tiranë (3 pozicione) dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë (1 pozicion), referuar kërkesës së nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, që kërkon përvojë minimale në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke pasur parasysh se tre janë fushat e të drejtës që përcakton ligji, konkretisht ajo administrative, civile dhe penale, ndërsa në kompetencën lëndore të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm nuk përfshihen gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative, pra për ngritjen në detyrë në këto gjykata nuk është e vlefshme përvoja në fushën e të drejtës administrative, Komisioni, sipas projektvendimeve të propozuara, ka vlerësuar se pozicionet për të cilat duhet të hapen procedurat e ngritjes në detyrë në këto gjykata apeli të jetë në dy fushat e së drejtës, konkretisht në ato civile dhe penale.

Për Gjykatën e Apelit Durrës, e cila ka vetëm një pozicion të lirë, sipas projektvendimit, Komisioni ka propozuar hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Për Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vetëm një pozicion të lirë, sipas projektvendimit, Komisioni ka propozuar hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, duke mbajtur në konsideratë për këtë se procedura e hapur më parë për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, dhe që u rihap përsëri, është për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Për Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vetëm një pozicion të lirë, sipas projektvendimit, Komisioni ka propozuar hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, duke mbajtur në konsideratë edhe në këtë rast se procedura e hapur më parë për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, është për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Ndërkohë, për Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka tre pozicione të lira, Komisioni ka propozuar hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, referuar të njëjtit kriter të konsideruar edhe më parë nga Këshilli, pra numrit të çështjeve sipas

llojit në lëndë të tyre, si dhe nevojës së gjykatës për gjyqtarë të profilizuar në të dy fushat e së drejtës.

Ndaj sa më sipër, referuar të njëjtës bazë ligjore si dhe për hapjen më herët të procedurave për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Komisioni ka përgatitur 6 projektvendimet e përmendura më lart.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve për çdo pozicion të lirë në secilën nga dy fushat e së drejtës, ato janë strukturuar në 4 Krerë, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e hapjes së procedurave për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas Vendimeve nr.173-186, datë 28.05.2020, me përjashtim të afatit të kandidimit i cili është përcaktuar “deri më datë 23.10.2020”.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit të parë i cili ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion në fushën e të drejtës civile, me një afat kandidimi deri më datë 23 tetor 2020. Jemi dakord me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale” me afat të kandidimit datë 23.10.2020. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i cili ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile, me afat kandidimi 23.10.2020.

Jeni dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro, dhe dua të shpjegoj edhe ndryshimin e qëndrimit lidhur me votën time për shkak të këtij projektvendimi, për shkak se në mbledhjet paraardhëse kam votuar kundër hapjes së procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për shkak se detyrimi ligjor ishte që ne duhet të respektonim njëherë lëvizjet paralele. Por duke marrë parasysh rregullimet e fundit që kemi bërë në rregulloren e lëvizjes paralele ku kemi parashikuar që Këshilli mund të konsiderojë të mos hapë një procedurë lëvizjeje paralele kur dëmtohet në shkallë të rëndë funksionaliteti i gjykatave, duke marrë parasysh edhe gjendjen në të cilën ndodhen këto gjykata apeli ku hapja e procedurave për lëvizje paralele do të nxirrte tërësisht jashtë funksioni ato - kujtojmë këtu që ne kemi gjykata apeli edhe vetëm me dy gjyqtarë ose vetëm me një trup gjykues – votoj pro në këtë rast të mos zbatohet procedura e lëvizjes paralele, por të hapen procedurat për ngritjen në detyrë.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e së drejtës civile”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Illir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile.

***Naureda Llagami***: Kemi projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, me të njëjtin afat kandidimi data 23 tetor. Jemi dakord?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Illir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ëpr një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, me të njëjtin afat të propozuar, data 23 tetor 2020. Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion në fushën e së drejtës penale.

\* \* \*

(Pika e 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |



Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do raportohet nga zoti Toska.

*Illir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka sjellë një projektvendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Bashkëlidhur projektvendimit është edhe relacioni shpjegues lidhur me këtë projektvendim. Shkurtimisht mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të përgjegjësisë dhe funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore ka miratuar: Vendimin nr.187, datë 28.05.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës

Administrative të Apelit”; dhe Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Në rastin e miratimit të këtyre vendimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur parasysh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, sipas organikës në fuqi të kësaj gjykate, është 13 (trembëdhjetë), ndërkohë që, në atë moment, në detyrë kanë qenë vetëm 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë.

Pra, në momentin e miratimit të vendimeve të lartpërmendura, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar se në Gjykatën Administrative të Apelit kishte një pozicion të lirë të përhershëm, krijuar prej datës 24.10.2019, për shkak të shkarkimit nga detyra me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar të një prej gjyqtarëve të saj.

Po ashtu, në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur parasysh edhe se vijimi i detyrës për një nga gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit pritej të përfundonte më datë 30.06.2020, ditë kur për të mbaronte statusi i magjistratit për shkak të dorëheqjes, deklaruar kjo me Vendimin e tij nr.158, datë 15.05.2020.

Pra, në momentin e miratimit të vendimeve të lartpërmendura, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar se në Gjykatën Administrative të Apelit, përveç një pozicioni të lirë të përhershëm, kishte edhe një pozicion tjetër që pritej të bëhej i lirë pas datës 30.06.2020, pra brenda 3 muajve.

Mbi këtë bazë, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit, përcaktuar dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e këtyre procedura të ngritjes në detyrë, që ka përfunduar më datë 15.06.2020, në procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit kandiduan gjyqtarët si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, lista e kandidatëve është: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, lista e kandidatëve është: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Ndërkohë, disa nga kandidatët për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pozicionet e lira si më lart rikonsideruan kandidimet e tyre. Kështu: z. {...}, më datë 03.07.2020, tërhoqi kandidimet për të dy pozicionet e lira, shkak për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.238/7, datë 07.07.2020, vendosi mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për këtë kandidat; z. {...}, më datë 03.07.2020, tërhoqi kandidimin për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, shkak për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.238/5, datë 07.07.2020, vendosi mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për këtë kandidat; znj. {...}, më datë 04.08.2020, tërhoqi kandidimin për njërin nga dy pozicionet e lira, pa përcaktuar specifikisht atë, por duke përcaktuar se vijonte kandidimin për atë pozicion të lirë për të cilin do të vijonte procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Mbas rikonsiderimit të kandidimeve si më lart, situata e kandidimeve në procedurat e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për dy pozicionet e lira, paraqitet si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, kandidatët janë {...} dhe {...}.

Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, kandidatët janë z. {...} dhe z. {...}.

Vlen të theksohet se kandidate në një nga këto procedura ngritjeje në detyrë është edhe gjyqtarja {...}, pikërisht në atë procedurë për të cilën, sipas saj, Këshilli do të vendoste vazhdimin e procedurës në kushtet kur në një nga pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli, më datë 30.07.2020, caktoi ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. {...}.

Ndërkohë, pas emërimit dhe fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, më datë 13.03.2020, të z. {...}, z. {...} dhe z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në disa mbledhje, shqyrtoi vazhdimin e qëndrimit në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të z. {...}, në raport me përcaktimin e nenit 136, paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pra për qëndrimin në detyrë deri në emërimin e pasardhësit. Në Mbledhjen Plenare të datës 11.06.2020, pra mbas hapjes së dy procedurave si më lart për ngritjen në

detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatoi përfundimin e detyrimit të qëndrimit në detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, të z. {...}. Në këtë rast, Këshilli vendosi të ftojë z. {...} për të shprehur qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, referuar neneve 61 dhe 62, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me shkresën nr.3032 prot., datë 01.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor njoftoi z. {...} mbi përfundimin e detyrimit të qëndrimit në detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, si dhe ftoi atë për të shprehur qëndrimin në lidhje me ushtrimin e të drejtës për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli.

Në përgjigje të njoftimit dhe ftesës së Këshillit, brenda afatit të caktuar, z. {...} depozitoi ne Këshill, më datë 07.07.2020, njoftimin për ushtrimin e të drejtës për t'u caktuar në nivel apeli.

Marrë shkas nga ushtrimi prej z. {...}, të të drejtës për t'u caktuar në nivel apeli, në funksion të realizimit të saj, por edhe me qëllim që ai të realizonte të drejtën e zgjedhjes deri në tre, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në pikën 1, të nenit 62 në lidhje me pikat 3 deri në 7, të nenit 60, por edhe në pikën 2, të nenit 62, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.260, datë 23.07.2020, vendosi:

“1. Publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë, si më poshtë:

- a) në Gjykatën e Apelit Tiranë;
- b) në Gjykatën e Apelit Durrës;
- c) në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë;
- d) në Gjykatën e Apelit Korçë;
- e) në Gjykatën e Apelit Shkodër;
- f) në Gjykatën Administrative të Apelit.

2. Gjyqtari {...} ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda datës 28 korrik 2020”.

Vendimi si më lart iu komunikua rregullisht gjyqtarit z. {...}, i cili, me kërkesën e protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me datë 28.07.2020, kërkoi që të caktohet në pozicion në nivel apeli pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.266, datë 30.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi caktimin në pozicion të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Sa më lart, rezulton se një nga dy pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë me Vendimet nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, aktualisht nuk ekziston më si i tillë, në kushtet e caktimit të përhershëm nga Këshilli, në një nga këto pozicione të lira, të gjyqtarit z. {...}.

Në kushtet kur shumica e Këshillit, në mbledhjen plenare të datës 10.09.2020, në rastin e shqyrtimit të projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për verifikimin e plotësisht të tre kritereve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit nga kandidatët {...}, {...} dhe {...}, nuk përkrahu kërkesën e Komisionit për vazhdimin e shqyrtimit të këtyre projektvendimeve dhe idenë për rishikimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata, brenda numrit të përgjithshëm të tyre, por vendosi shtyrjen e shqyrtimit të projektvendimeve në fjalë, duke i kërkuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si komisioni përgjegjës për karrierën, të paraqiste më parë për shqyrtim përpara Këshillit projektvendimin përkatës në lidhje me mosvijimin e një prej procedurave të hapura më datë 28.05.2020, për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Shkaku i përgatitjes së këtij projektvendimi të propozuar është fakti se vazhdimi i një prej procedurave të hapura më datë 28.05.2020, për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, aktualisht është bërë i pamundur, pasi në një nga pozicionet e lira, Këshilli, me vendimin e datës 30.07.2020, caktoi në mënyrë të përhershme gjyqtarin z. {...}.

Pozicioni i lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, procedura e ngritjes në detyrë për të cilin, sipas projektvendimit, propozohet të deklarohet e përfunduar, është ai i

shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lidhur më këtë, Komisioni ka në konsideratë qëndrimin e mbajtur nga shumica e Këshillit në rastin e marrjes së Vendimit nr.260, datë 23.07.2020, përmes të cilit gjyqtari z. {...} është ftuar të zgjedhë, ndër të tjera, edhe një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, pikërisht pozicionin që pritej të bëhej i lirë në momentin e hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë më datë 28.05.2020, pra pozicionin e dytë në rend kronologjik. Po ashtu, Komisioni ka në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga shumica e Këshillit, në mbledhjen plenare të datës 10.09.2020, në rastin e shtyrjes së projektvendimeve për verifikimin e plotësimit të tre kritereve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit nga kandidatët {...}, {...} dhe {...}, pra të kandidatëve që kanë kandiduar për pozicionin e shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020.

Projektvendimi i propozuar përbëhet nga tre pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që vendimi u njoftohet gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ndërsa në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet se vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Toska!

Atëherë, keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin e propozuar?

**Brikena Ukperaj:** Kam një pyetje zonja Kryetare për Komisionin.

Si i ka vlerësuar Komisioni kandidaturat që kanë shprehur vullnetin për të kandiduar në këtë pozicion sepse nuk zgjidhet në projektvendim se çfarë bëhet me

kandidaturat që kanë aplikuar. Disa nga kandidaturat kanë aplikuar për dy pozicione, ndërkohë që është një kandidaturë që ka aplikuar vetëm për këtë pozicion.

**Ilir Toska:** Sipas projektvendimit të propozuar, ne nuk kemi bërë ndonjë propozim konkret për sa pyesni.

**Brikena Ukperaj:** Mund të vazhdoj Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

Referuar edhe bazës ligjore të përcaktuar në projektvendim që është neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, organi publik mund të deklarojë të përfunduar një procedurë administrative kur objekti për të cilën është nisur procedura ose qëllimi është i pamundur. Në rastin konkret, duke qenë se nisjen e një procedure për ngritjen në detyrë varet nga ekzistenca e një vendi vakant, sigurisht që jemi në rastet kur për procedurën ose zbatimin e nenit 95 për sa i përket përfundimit të procedurës.

Por çfarë ndodh? - Përfundimi i kësaj procedure do të afektojë drejtpërsëdrejti një nga kandidatët, e afekton më shumë, një nga kandidatët që ka aplikuar për ngritje në detyrë në këtë procedurë (z. {...}, me sa konstatoj nga vendimet), për të cilin, nëse projektvendimi do të mbetet vetëm me mbylljen e procedurës, do të thotë që përfundon, nëse nuk do të rregullohen pasojat, do të përfundojë edhe procedura e kandidimit të tij.

Në zbatim të parimit të ligjshmërisë të parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative, për shkak të të cilit ne duhet të rregullojmë pasojat që shkaktohen nga mbyllja e kësaj procedure për personat që preken nga kjo procedurë, duke qenë se tashmë kemi vetëm një vend vakant për të cilin ka edhe kandidatë që kanë aplikuar në të dyja procedurat, vlerësoj që ose të bëhet një shtim i një pike të veçantë në këtë vendim, duke konsideruar kandidaturën e zotit {...} të vlefshme edhe për procedurën e vendimit tjetër, pra për procedurën e vendimit 187, ose të vendoset bashkimi i të dy procedurave në një procedurë të vetme për plotësimin e një vendi vakant, pa konsideruar se cilën nga të dyja procedurat mbyllim.

Kjo është për diskutim edhe për anëtarët e tjerë, duke qenë se edhe në mbledhje të tjera kemi shprehur indirekt mendimin që nuk ka cenim sepse nuk ka problem që të gjitha kandidaturat të mblidhen në kuadër të një procedure të vetme.

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim?

**Ilir Toska:** Po! –mund të diskutoj unë?

Lidhur me propozimin e zonjës Ukperaj sa i përket bashkimit të dy procedurave për ngritjen në detyrë, unë kam mendim kundër. Nuk mund të bashkojmë dot dy procedura në një të vetme, kjo për faktin se çdo procedurë i korrespondon një pozicioni i lirë. Në kushtet kur ne nuk e kemi një pozicion të lirë, praktikisht nuk kemi procedurë dhe nuk kemi sesi të bashkojmë dy procedura.

Nga ana tjetër, sa i përket propozimit që të përfshijmë si pikë të projektvendimit konsiderimin e kandidimit të z. {...} për pozicionin që ne do të vijojmë procedurën, pra atë të shpallur me vendimin nr. 187, unë shprehem dakord.

**Alban Toro:** Mund të flas?

**Naureda Llagami:** Po, Alban!

Jam dakord me atë sa shprehu kolegu parafolës në lidhje me mospërfshirjen në këtë projektvendim të propozimit të Brikenës dhe dua të shtoj vetëm faktin që këtu bëhet fjalë për ligjshmërinë e aktit administrativ, parashikuar në nenin 107 të Kodit të Procedurës Administrative, ligjshmëri të cilën mund ta kontrollojë vetëm një instancë kontrolluese siç është gjykata. Kështu që, nëse do të kemi ndonjë cenim interesi, gjyqtari të cilit i është cenuar interesi, mund të kontrollojë formalisht në gjykatë ligjshmërinë e aktit tonë, si në rastin kur është mbyllur ky pozicion pa të drejtë, nëse ai ka një pretendim të tillë apo në rastin kur dikush ka ndërprerë konkurrimin për të përfshirë në mes të garës një person tjetër. Kështu që le t'ia lëmë gjykatës ligjshmërinë e akteve tona dhe nëse do të kemi edhe një padi për këtë shkak. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Keni ndonjë diskutim tjetër?

**Brikena Ukperaj:** Kryetare, mund të vazhdoj me një propozim konkret se ndoshta është më e thjeshtë edhe për t'u votuar nga të gjithë anëtarët e Këshillit?

**Naureda Llagami:** Po Brikena, mund ta formulosh?

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, duke marrë parasysh edhe ometimin e shprehur nga zoti Toska, propozoj që pas pikës 1 në projektvendimin e përgatitur nga Komisioni, të



parashikohet një pikë 2, ku konkretisht të parashikohet që kandidimi i z. {...} në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të konsiderohet si kandidim në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shtimi i kësaj pike do të afektojë edhe pikën 3 ku në subjektet që do të njoftohen, do të jetë edhe zoti {...} i cili është edhe ai kandidat në procedurën e ngritjes në detyrë për sa i përket vendimit nr. 187. Pra të gjithë kandidatët duhet të njoftohen për këtë vendim të Këshillit sepse ndryshon të gjithë grupin e kandidatëve që kandidojnë për këtë vend vakant.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim, nëse s'keni diskutime?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim propozimin e Brikenës, pra për të shtuar një pikë me idenë që të përfshihet në procedurë edhe zoti {...}.

**Maksim Qoku:** Dakord me propozimin e Brikenës.

**Brunilda Kadi:** Kundër, me arsyetimin që kjo nuk ka bazë ligjore dhe për sa i përket parimeve, ato duhet të ishin pasur parasysh kur u votua që u mbyll kjo procedurë kandidimi, duke cenuar shumë parime të tjera. Dhe që mos përsëris, ideja është, tek argumenti që dha zoti Toro, nëse kandidati/magjistrati është cenuar nga ai vendim i Këshillit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë tek institucioni që kontrollon vendimet e Këshillit. Pra jam kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër, jo vetëm për shkaqet që thash më sipër por edhe për faktin se bie në kundërshtim me nenin 48 të ligjit për Statusin. Faleminderit!

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, pranohet propozimi i Brikenës.

Kalojmë në miratimin në tërësi të projekt-aktit, së bashku me propozimin.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, përderisa Këshilli me shumicë vendosi pro, unë jam e detyruar të votoj pro tani në tërësi për aktin edhe pse për pjesën që unë isha kundër, u votua ndryshe.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Pjesërisht dakord. Jam dakord me aktin siç është formuluar dhe paraqitur nga Komisioni dhe kundër përfshirjes së propozimit bërë nga kolegja.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord, përveç pikës që u shtua nga Këshillit.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, së bashku me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj.

\* \* \*

(Pika e 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 62, datë 30.01.2020 dhe nr. 66, datë 06.02.2020.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 62, datë 30.01.2020 dhe nr. 66, datë 06.02.2020.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, i ndryshuar. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Maksim Qoku.

*Maksim Qoku:* Faleminderit, Kryetare!

Bazuar në nenin 53 të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 274 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Shkolla e Magjistraturës organizoi provimin e pranimit për vitin akademik 2020-2021.

Me anë të shkresës nr. 493 prot., datë 17.07.2020, shkresës nr. 610/1 prot, datë 04.09.2020, shkresës nr. 697 prot, datë. 09.09.2020 dhe shkresës nr. 697/1 prot, datë 23.09.2020, Shkolla e Magjistraturës ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se, pas përfundimit të provimit të pranimit, dhe miratimit të listës së renditjes së kandidatëve me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me Vendimin nr. 22, datë 16.07.2020, ka miratuar gjithsej 12 kandidatë për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, prej të cilëve 5 kandidatë për Këshilltarë Ligjorë dhe 7 kandidatë për Ndhmës Ligjorë, konkretisht: Këshilltarë ligjorë – {...} – {...}, dhe Ndhmës Ligjorë - {...} – {...}.

Gjithashtu duke pasur parasysh rezultatet e marra mbi 50% të pikëve totale nga ana e kandidatëve që morën pjesë në provimin e pranimit, si dhe faktin që vendet vakante të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk janë plotësuar, SHM, me anë të shkresave të lartpërmendura, ka dërguar dosjet e kandidatëve të cilët kanë marrë mbi 50% të pikëve totale. Për sa më sipër SHM i kalon Këshillit për vendimmarrje dosjet e kandidatëve të cilët mund të plotësojnë kriteret për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Në shkresat e dërguara nga SHM, numri total i kandidateve është 35, të cilët kanë marrë mbi 50% të pikëve totale, por emri i znj. {...}, është përcjellë dy herë nga SHM.

Me shkresën nr. 610/1, datë 4.9.2020 është përcjellë vetëm një kandidat, znj. {...}, e cila plotëson kushtet ligjore për Këshilltar Ligjor dhe nëpërmjet komunikimit me e-mail zyrtar (emaili konfirmues, bashkëlidhur relacionit) ka dhënë pëlqimin e saj të ndjekë për një periudhë 9-mujore, Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Në shkresën nr. 697 prot, datë 09.09.2020, SHM ka përcjellë një listë me 6 kandidatë, ku një nga 6 kandidatët, konkretisht znj. {...}, ka plotësuar formularin e aplikimit për profilet Këshilltarë Ligjorë dhe Ndhmës Ligjorë por, me Vendimin nr. 156, datë 15.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur skualifikimin e kandidates për të

marrë pjesë në provimin e pranimit për Këshilltarë Ligjorë dhe Ndhmës Ligjorë, pasi nuk provohen vitet e përvojës profesionale, për shkak të natyrës së punës që ka kryer.

Në lidhje me 5 kandidatët e tjerë të dërguar nga SHM, Këshilli ka verifikuar plotësimin e kriteve, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, ku ka rezultuar së 1 kandidat, konkretisht znj. {...}, ka plotësuar kriteret për Këshilltarë, ndërsa 4 kandidatë, konkretisht z. {...} – {...}, kanë plotësuar kriteret vetëm për Ndhmës Ligjorë.

Këta kandidatë gjithashtu, janë kontaktuar nga Këshilli, nëpërmjet e-mail-it, për të dhënë pëlqimin e tyre për të ndjekur për një periudhë 9-mujore, Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021 dhe vetëm 1 prej kandidatëve, konkretisht znj. {...}, ka shprehur interesin për profilin Këshilltar, ndërsa 4 kandidatët e tjerë, konkretisht z. {...} – {...}, të cilët plotësonin kriteret për t'u pranuar si Ndhmës Ligjorë, nuk kanë dhënë pëlqimin për vazhdimin e programit për formim fillestar.

Në shkresën nr. 697/1 prot, datë 23.09.2020, SHM ka përcjellë një listë me 28 kandidatë (lista bashkëlidhur relacionit), prej të cilëve pas verifikimit të bërë nga ana e Komisionit të përkohshëm vetëm 7 kandidatë plotësonin kushtet ligjore për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, konkretisht znj. {...}, plotëson kushtet për Këshilltar, dhe znj. {...} – {...}, plotësojnë kushtet për Ndhmës Ligjorë. Saktësojmë së znj. {...}, është përfshirë dy herë në listë nga SHM.

Këta kandidatë gjithashtu, janë kontaktuar nga Këshilli, nëpërmjet e-mail-it, për të dhënë pëlqimin e tyre për të ndjekur për një periudhë 9-mujore, Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021. Kanë shprehur pëlqimin për vazhdimin e programit për formimin fillestar si Ndhmës Ligjorë, vetëm 2 kandidatë, konkretisht znj. {...}, znj. {...}, ndërsa 4 kandidatët e tjerë, konkretisht znj. {...} – {...}, të cilët gjithashtu plotësonin kriteret për t'u pranuar si Ndhmës Ligjorë, nuk kanë dhënë pëlqimin për vazhdimin e programit për formim fillestar.

Bazuar në Vendimin nr. 31, datë 23.01.2020, “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021 (i konsoliduar), të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet se numri i kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për

një periudhë prej 9 muajsh programin e formimit fillestar, për vitin akademik 2020-2021, është 25 (njëzet e pesë).

Në kushtet kur vetëm 12 kandidatë, kanë marrë mbi 50% të pikëve dhe kanë shprehur vullnetin për të filluar studimet për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë në vitin akademik 2020-2021, konkretisht, {...} – {...}, për Këshilltarë Ligjorë dhe {...} – {...} për Ndhmës Ligjorë, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve dhe Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej 9 muajsh programin e formimit fillestar, pasi ka marrë konfirmimet nga kandidatët, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithashtu dhe miratimin e kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...} për Këshilltare Ligjore, dhe znj. {...}, znj. {...} për Ndhmëse Ligjore, të cilët kanë plotësuar kriteret e pranimit dhe kanë shprehur vullnetin për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Për më tepër, anëtarët disponojnë edhe projektvendimin në fjalë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Qoku!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Përkohshëm?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Pjesërisht kundër vetëm për sa i takon pjesës së Këshilltarëve Ligjorë sepse në opinionin tim ata nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 34, pika 6 e ligjit 98/2016. Faleminderit!

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Erjon Muharremaj:** Kryetare, më falni që ju ndërpres, mund të bëj një ndërhyrje. Nisur nga votimi i zotit Toro që sapo bëri, mendoj që duhet të sqarohet procesi i votimit sepse në vlerësimin tim vota “pjesërisht kundër” do të thotë në gjuhën shqipe edhe “pjesërisht pro”, ndërkohë që referuar ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk lejohet abstenimi, që do të thotë, mund të votohet “pro” ose “kundër”. Mendoj që duhet të sqarohet kjo për votimet e mëtejshme sepse mendoj që krijon konfuzion. Faleminderit!

**Alban Toro:** Mundet të flas?

**Naureda Llagami:** Po!

**Alban Toro:** Më duket se e sqarova votën. Thashë që në listën e Këshilltarëve, pra emrat nominativ që paraqiten në Lidhjen 1 dhe që i përkasin Këshilltarëve Ligjorë, jam kundër. Që do të thotë, për këtë pjesë të aktit unë jam kundër. Ndërsa pjesa tjetër e Ndhmësve Ligjorë jam pro. Nuk e besoj se ka ndonjë kontradiktë. Megjithatë kjo është pjesë që ne mund ta zgjidhim tek rregullorja e posaçme që do bëhet për Këshillin. Kështu që nuk i takon këtij momenti. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kjo çështje është në fakt e rregullores së brendshme të Këshillit, mënyra e votimit dhe si do shprehen votat, kështu që ta kemi parasysh, grupi i punës që po merret me atë rregullore.



\* \* \*

(Pika e 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)

- 10. Marçela Shehu* (anëtare)  
*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”. Ky projekt-akt vjen si bashkëpropozim i dy komisioneve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zonja Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të bërë të mundur realizimin e detyrimeve kushtetuese të parashikuara në nenin 147 të Kushtetutës dhe atyre ligjore që diktojnë ligjet e reformës në drejtësi, si një organ që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe

mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përgjatë veprimtarisë së tij, ka detyrimin të miratojë një numër të madh aktesh administrative të natyrës normative, individuale, rregullore të brendshme e udhëzime jodetyruese. Për të bërë të mundur këtë duhet: një strukturë organizative mirëfunktionale e tij dhe e administratës; përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të të gjitha njësive organizative dhe pozicioneve individuale; rregulla procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të tillë që të bashkëpunojë e bashkërendojë punën, për të siguruar mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Në funksion të sa më sipër, Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 strukturën organizative të administratës, e cila është përmirësuar më tej, duke parashikuar në këtë strukturë, ndër të tjera, edhe Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Kjo njësi mbështet dy nga komisionet e ngritura në KLGJ, atë të përhershëm për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe atë të përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka në organikën e saj 7 pozicione nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, nga të cilat 6 janë aktualisht të zëna dhe një pozicion është vakant. Dua të sqaroj këtu se pasi është përgatitur nga dy Komisionet ku relacion, kemi ardhur në dijeni që edhe një anëtar tjetër i kësaj Njësie ka dhënë dorëheqjen, por që për shkak të efekteve të saj, siç ka ardhur edhe një propozim, ato mund t'i shtrijnë efektet deri në fund të muajit pasardhës.

Aktualisht të gjithë nëpunësit përgjegjës për vlerësimin kanë statusin e magjistratit. Për shkak të ecurisë së procesit të vlerësimit periodik, gradimit e vlerësimit të përsheptuar dhe atij ndihmës për organet e rivlerësimit, ku nëpunësi përgjegjës për vlerësimin konsiderohet edhe ai për efekt të ligjit “vlerësues”, është nevojë urgjente plotësimi tërësisht i kësaj strukture. Prandaj, për të pasur kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, propozon që pranë kësaj Njësie të komandohet edhe 1 gjyqtar tjetër. Për këtë komisionet iniciues të këtij projektvendimi, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, propozojnë që Këshilli të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e një pozicioni “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Referuar nenit 54, pika 2 të Ligjit për Statusin, në një procedurë komandimi, Këshilli shpall kërkesën për kandidatura, gjithmonë pasi ka bërë vlerësimin e nevojave të tij, duke nënkuptuar në këtë rast nevojat e gjithë sistemit ku dhe ai bën pjesë. Në rastin konkret krijohet perceptimi i përballjes së nevojave që kanë vetë aktorët e sistemit të drejtësisë. Këshilli ka nevojë për staf të kualifikuar që duhet të vijë nga radhët e gjyqtarëve, ndërkohë që edhe gjykatat kanë nevojë për gjyqtarë. Por për shkak të emërimit të të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, fazë në të cilin Këshilli ndodhet aktualisht, ka pritshmëri të zbutjes së shkallës së dëmtimit të funksionalitetit të gjykatave të shkallës së parë, e në këtë këndvështrim, është vlerësuar që komandimi i një gjyqtari në pozicionin e nëpunësit përgjegjës është i mundshëm.

Me anë të këtij vendimi, rregullohet shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit nëpunës përgjegjës për vlerësimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatja e shpalljes, kriteret e vendosura dhe procedura e komandimit në atë pozicion.

Në Kreun e Parë të vendimit, shpallja e kërkesës për kandidatura, përcaktohet se kërkesa shpallet për plotësimin e 1 pozicioni “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Afati i paraqitjes së kërkesave do jetë 5 ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit pranë faqes zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në rastin konkret është vlerësuar lënia e afatit 5 (pesë) ditor, për shkak të nevojës urgjente të diktuar nga ecuria e procesit të vlerësimeve, por edhe për faktin që në këtë rast Këshilli vepron jo vetëm si organ që realizon procedurën e komandimit, por edhe si institucion që ka të nevojshëm komandimin e një gjyqtari.

Në pikën 3 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë. Janë të njëjtat kriteret, të njëjtat dokumente që ne kemi kërkuar edhe në rastet e procedurave të tjera.

Në Kreun e dytë, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Në pikën 4 të Kreut të dytë, jepen kriteret e komandimit që janë: eksperiencia në punë si gjyqtar jo më pak se 3 vjet; komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; kandidati të mos jetë i komanduar; kandidati që ka qenë i komanduar më parë, të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; si dhe kushti që kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Janë parashikuar të njëjtat kritere për kandidatin që do të ketë përparësi kur ka më shumë se një kandidat gjatë procedurës së përzgjedhjes. Si i tillë ai duhet të ketë ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë; duhet të ketë njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor; duhet të jetë autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; duhet të ketë njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; si dhe duhet të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, personale dhe angazhimi profesional, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Në pikën 6, përcaktohet dokumentacioni mbi bazën e të cilit do bëhet vlerësimi.

Në pikën 7, përcaktohet procedura që do ndiqet nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vlerësimin nëse komandimi i kandidatëve është apo jo në përputhje me interesat e lartë të gjykatës. Për këtë gjë përgatitet një projekt-opinion përkatës i cili publikohet edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

Në pikën 8 të këtij Kreu, përcaktohet procedura që do zbatohet më pas për vlerësim pas përgatitjes së opinionit. Kjo procedurë ndiqet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Në pikën 9, përcaktohet afati dyjavor brenda të cilit ky Komision duhet të pasqyrojë të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kritereve të komandimit, të bëjë renditjen dhe të vijë në mbledhjen plenare me emrin e kandidatit të renditur më lart.

Në pikën 10, parashikohet se jo më vonë se një javë nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit thërret mbledhjen plenare, për te vendosur në lidhje me komandimin.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 11, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për gjyqtarin kandidat të propozuar. Gjithashtu në këtë pikë përcaktohet se në rast të mosmiratimit të propozimit, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit.

Ndërkohë në pikën e fundit rregullohet situata ligjore kur asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet. Në këtë rast Këshilli mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit vakant “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të ardhur nga Komisionet?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

\* \* \*

(Pika e 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

10.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtares znj. {...}”;

10.2 “Për caktimin e gjyqtares së Skemës së Delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës”;

10.3 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

10.4 “Për caktimin e gjyqtarit së Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

10.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtares znj. {...}”;

10.2 “Për caktimin e gjyqtares së Skemës së Delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës”;

10.3 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

10.4 “Për caktimin e gjyqtarit së Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtares znj. {...}”; “Për caktimin e gjyqtares së Skemës së Delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës”; Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Në vijim të përpjekjeve që ky Këshill ka bërë për të përfshirë sa më shumë gjyqtarë në skemën e delegimit, më datë 15.09.2020 nga znj. {...} është shprehur pëlqimi për t'u përfshirë në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë. Zonja {...} është gjyqtare e dekretuar me dekretin e Presidentit 7205, 21.12.2011 është emëruar përfundimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku edhe aktualisht ushtron funksionin e saj.

Në përputhje me nenin 45 të ligjit 96/2016 si dhe vendimit nr. 22, 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, Komisioni ka vlerësuar se jemi në kushtet e pranimi të përfshirjes së kësaj gjyqtareje, pasi plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore. Gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t'u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektin e një mase disiplinore në zbatimin e së cilët mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemë delegimi; nuk ushtron funksionin e kryetarit apo zëvendëskryetarit; të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj, pasi aktualisht rezulton që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ushtrojnë funksionin 12 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 15 gjyqtarë; të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Për rrjedhim, në këto kushte është përgatitur projekti përkatës në dispozitivin e të cilit do t'ju sugjerohet të miratoni:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfshirjen e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.  
Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtares znj. {...}”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Edhe për këtë e ka fjalën zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Në kushtet kur Këshilli sapo miratoi caktimin e zonjës {...} në skemën e delegimit, komisioni më tej ka përcaktuar edhe Gjykatën e Apelit Durrës si një gjykatë e cila është në nevojë, pasi aktualisht ka një numër të kufizuar gjyqtarësh. Në detyrë janë 4, nga 13 që duhet të kishte. Gjithashtu çështjet gjyqësore në pritje apo që janë në gjykim janë të konsiderueshme. Gjithashtu ka edhe kërkesa të vazhdueshme për caktim gjyqtarësh për çështje të caktuara.

Kështu që, në këto kushte, Komisioni ju propozon që zonjën {...} ta caktojmë si gjyqtare të skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, duke marrë në konsideratë që ajo kandidon dhe në bazë të vendimit të Këshillit nr. 174, 28.05.2020 për këtë gjykatë, kështu që natyrisht përafrohet edhe me dëshirën e saj për të kontribuar pranë Gjykatës së Apelit.

Kështu që, në këto kushte, Komisioni ju ka përgatitur një projekt draft, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 07.10.2021.
2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Durrës për periudhën deri më datë 15.11.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Durrës.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj.{...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.  
Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e caktimit të gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Durrës, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}. Edhe për këtë është relator zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Edhe zoti {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka shprehur pëlqimin për të marrë pjesë në skemën e delegimit. Më datë 21.09.2020 ai ka konkretizuar me një shkresë drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zoti {...} e ka ushtruar këtë detyrë me dekretin 7201, datë 21.12.2011 ku është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në përputhje me nenin 45 si dhe vendimin nr. 22, 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni ka vlerësuar se jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarit {...} në skemën e delegimit, pasi i ka përmbushur kriteret për këtë. Gjyqtari ka dhënë pëlqimin, i cili disponohet nga ana jonë nëpërmjet shkresës. Ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion. Nuk ndodhet nën efektin e ndonjë mase disiplinore. Nuk ushtron funksionin e kryetarit apo zëvendëskryetarit. Është caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj,

pasi aktualisht rezulton se në gjykatë ushtrojnë funksionin 11 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 14. Nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak transferimi të përkohshëm me apo pa pëlqim.

Në të tilla kushte, ju sugjerojmë të miratoni projektvendimin bashkëlidhur këtij relacioni, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.
2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e komandimit në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin “Për caktimin e gjyqtarit së Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”. Edhe për këtë projekt-akt, fjalën e ka sërish zoti Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Në vijim të pranimit të përfshirjes së zotit {...} në skemën e delegimit, Komisioni ka identifikuar gjykatën në nevojë e cila është ajo e Apelit Vlorë, për të caktuar këtë gjyqtar të skemës së delegimit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Organika e Gjykatës së Apelit Vlorë është 12 gjyqtarë, ndërkohë që në detyrë janë vetëm 6 të tillë. Pra një numër i pamjaftueshëm për të pasur në konsideratë çështjet që ka në ngarkim kjo gjykatë për të shqyrtuar apo kërkesat për një numër të lartë çështjesh që vijnë nga kjo gjykatë për caktim gjyqtarësh nga gjykata të tjera të apelit sipas vendimit të Këshillit nr. 30/2019.

Kështu që, në këto kushte ne kemi vlerësuar t’ju sugjerojmë miratimin e projektvendimit bashkëlidhur këtij relacioni, në dispozitivin e të cilit do të gjeni:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për periudhën deri më datë 07.10.2021.
2. Gjyqtari në skemën e delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykata e Apelit Vlorë për periudhën deri më datë 30.10.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.



4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Një kopje e vendimit i njoftohet Gjyqtari në skemën e delegimit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Nëse kolegët kanë diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votim.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin “Për caktimin e gjyqtarit së Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Vlorë”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Kryetare**

**Naureda Llagami**

**Specialiste**

**Rosalba Xhabrahimi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës<sup>1</sup>.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e fundit është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Fjala i jepet zotit Toska për më shumë detaje lidhur me relacionet.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur relacionet për 7 gjykata të cilat kanë paraqitur nevojë për caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet.

Janë edhe disa kërkesa nga gjykata të tjera, por është konsideruar të paraqiten ato për trajtim pranë Këshillit në një moment të dytë, ndërkohë që duhet të procedohet me emërimin dhe caktimin në pozicion të sapodiplomuarve për magjistratë.

Fillimisht zoti Toska propozon radhën e procedurave të shortit: Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas kësaj radhe: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan; Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese:

Në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Mat, të mos përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z. Murat Lleshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Murat Lleshi dhe Rexhep Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z.Arbër Çela.

Në shortimin e çështjes nr.2 të përjashtohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z.Tonin Sterkaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Luveda Dardha.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Luveda Dardha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (pjesë e seksionit për të mitur).

Propozimet vijuese:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet gjyqtarja Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që ka depozituar kërkesë për komandim në skemën e delegimit, konkretisht: Znj. {...} (pak më herët u caktua në skemën e delegimit).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Piro Sota.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (pjesë e seksionit për të mitur).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Lutfije Celami.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, në 4 lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Propozimet vijuese:

Për 4 çështjet penale, ato me nr. 1 - nr. 4, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për 1 çështje civile, atë nr. 5, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në shortimin e çështjeve penale të përjashtohet nga shorti: Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo; Gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e 3 apo më shumë çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Sokol Pasho; Znj. Vjollca Spahiu; Z. Gerd Hoxha; Z. Kastriot Gramshi; Z. Bedri Qori.

Në shortimin e çështjes civile të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Klorinda Çela; Znj. Antonela Prendi; Znj. Enkela Bajo; Znj. Blerina Muça; Znj. Fida Osmani; Znj. Fatime Deçolli; Znj. Anila Capo (Zëre); Z. Arjan Aliaj; Znj. Anila Karanxha; Znj. Manjola Xhaxho; Z. Flamur Kapllani; Z. Altin Shkurti; Znj. Mimoza Kajo; Znj. Arjana Gunbardhi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Ardjana Bera.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ahmet Metaliaj dhe Oltjona Goxha.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Ardjana Bera.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Ahmet Metaliaj dhe Oltjona Goxha.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtarja Dhurata Balla.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.



Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (seksioni civil).

Propozimet vijuese:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Klorinda Çela; Znj. Antonela Prendi; Znj. Enkela Bajo; Znj. Blerina Muça; Znj. Fida Osmani; Znj. Fatime Deçolli; Znj. Anila Capo (Zëre); Z. Arjan Aliaj; Znj. Anila Karanxha; Znj. Manjola Xhaxho; Z. Flamur Kapllani; Z. Altin Shkurti; Znj. Mimoza Kajo; Znj. Arjana Gunbardhi, përfshirë edhe zonjën Dhurata Balla që u caktua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Do duhet të përjashtohen nga shorti dy gjyqtarët që janë caktuar për gjykimin e kësaj çështjeje që janë znj. Fatime Deçolli dhe Flamur Kapllani që janë në trup gjykues.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Rezarta Balliu.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për 2 çështje gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështje gjyqësore të veçanta, të jetë 5.

Propozimet vijuese:

Për 2 çështje, për të cilat kërkohen 2 dhe 3 gjyqtarëve, të caktohen 5 të tillë, të cilët të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart. Në këtë rast, një gjyqtar nuk mund të caktohet në më shumë se 1 çështje. Po ashtu, për çështjen nr. 1 nuk duhet të jenë relator gjyqtarët Alma Kolgjoka, Esmeralda Xhili (Çeka), Manjola Xhaxho dhe Rexhep Bekteshi. Këta gjyqtarë janë caktuar më herët në gjykatat e posaçme, duke u caktuar edhe relatorë në disa nga këto çështje.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Sistemi në pikëpamje teknike nuk mundëson të ekzekutojë propozimin e fundit që të mos caktohen relatorë gjyqtarët Alma Kolgjoka, Esmeralda Xhili (Çeka), Manjola Xhaxho dhe Rexhep Bekteshi. Nëse do të ndodhë, atëherë do duhet të rihidhet shorti derisa të ekzekutohet ky propozim.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Shorti duhet të përsëritet duke qenë se shorti i bie gjyqtarës Alma Kolgjoka si relatorë.

Ripërsëritet shorti:

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Emona Muçi dhe Manjola Xhaxho.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ornela Naqellari (relatore), Esmeralda Xhili dhe Rexhep Bekteshi (anëtarë)

\* \* \*

(Pika e 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.10.2020)*

**Diskutim jashtë rendit të ditës mbi daljen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me një deklaratë për shtyp me qëllim inkurajimin nga radhët e gjyqtarëve për të aplikuar në Gjykatën Kushtetuese.<sup>2</sup>**

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 14:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*

<sup>2</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

- 10. Marçela Shehu* (anëtare)  
*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

Përpara se të mbyllet mbledhja, **zonja Llagami** parashtron se ka dërguar një e-mail me një deklaratë për shtyp që nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë është bërë me qëllim për të inkurajuar nga radhët e prokurorëve (në rastin konkret) për të aplikuar në Gjykatën Kushtetuese.

Deri tani vetëm dy anëtarë kanë kthyer përgjigje dhe për këtë shkak zonja Llagami kërkon që të diskutohet kjo çështje, nëse duhet të mbahet nga Këshilli i njëjti qëndrim si KLP-ja.

**Zoti Toska** merr fjalën për të shprehur mendimin e tij. Në parim zoti Toska është dakord që të bëhet një deklaratë e tillë sensibilizuese për t'i ftuar gjyqtarët që kanë kaluar procesin e rivlerësimit për të konkurruar për në Gjykatën Kushtetuese, sa kohë plotësimi dhe vënia në funksion e Gjykatës Kushtetuese është një çështje me rëndësi kombëtare, pasi përbën një nga kushtet për fillimin e bisedimeve të Shqipërisë për adresimin në Bashkimin Evropian. Gjyqtarët që janë në sistemin gjyqësor dhe zhvillojnë karrierën në Gjykatën Kushtetuese do duhet t'iu garantohet ajo që iu garanton ligji për Gjykatën Kushtetuese, pra caktimin mbas përfundimit të mandatit në një pozicion të

barasvlershëm. Këtë gjë mund ta bëjë vetëm Këshilli i Lartë Gjyqësor, sa kohë bëhet fjalë për gjyqtarë të karrierës. Gjithsesi, mendimi i zotit Toska është që përveç kësaj deklaratë, Këshilli do duhet të kërkojë që Ministrja e Drejtësisë të iniciojë një proces për të ndërhyrë në legjislacion, për të garantuar pikërisht rikthimin dhe vijimin e karrierës gjyqësore për çdo gjyqtar që zgjidhet si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Vetëm ligji mund t'ia japë përfundimisht këtë garanci. Deklaratat e Këshillit tregojnë thjesht opinionin e Këshillit për interpretimin e ligjit apo ajo që duhet të ndodhë në fakt, që është diçka e drejtë, por që ligji do duhet të garantojë këtë gjë në mënyrë të shprehur.

*Zoti Qoku* është në Grupin e Punës të ngritur në Ministrinë e Drejtësisë për rishikimin e paketës së drejtësisë dhe aty mund të adresohet konkretisht propozimi i zotit Toska.

Merr fjalën *zonja Luli* në vijim për të shprehur dakordësinë që në parim mund të bëhet një deklaratë e tillë, por do duhet të themi në deklaratë që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë duhen ndërmarrë nisma ligjore për ta caktuar në ligj këtë të drejtë gjyqtarëve, për t'u kthyer në gjykatën ku kanë qenë, pas mbarimit të mandatit në Gjykatën Kushtetues, sepse vetëm kështu mund të jetë një deklaratë e plotë, kjo për të treguar që Këshilli ka vullnet dhe veprimet e duhura ligjore i ndërmerr për të realizuar këtë vullnet.

Edhe *zonja Shehu* bie dakord me sa parashtruan kolegët dhe në fakt që dje kur u nis e-maili nga ana e Kryetares së Këshillit, zonja Shehu ka dërguar qëndrimin e saj duke qenë dakord. Kjo është e vetmja mënyrë për t'i shtyrë gjyqtarët që të kandidojnë. Këshilli do donte që në Gjykatën Kushtetuese të kishte gjyqtarë pa mohuar të gjithë ndihmesën e madhe që do të jepnin juristët e tjerë, profesorët, avokatët, por për Këshillin është shumë e rëndësishme që në Gjykatën Kushtetuese të ketë edhe përfaqësues që vijnë nga radha e gjyqësorit, me qëllim dhënien e kontributit e tyre edhe në këtë gjykatë. Pengesat ligjore aktuale dihen dhe i dinë edhe vet gjyqtarët. Në këtë deklaratë duhet të tregohet angazhimi maksimal i Këshillit si dhe qëndrimin e Këshillit lidhur me këtë situatë, duke shprehur të

gjithë përkushtimin dhe angazhimin e Këshillit, për të propozuar këto ndryshime ligjore, me qëllim garantimin më pas të rikthimit në detyrë në një pozicion të barasvlershëm, siç parashikon edhe ligji për Gjykatën Kushtetuese. Kështu edhe zonja Shehu bashkohet me kolegët dhe ndërkohë të vijohet pa vonesë puna lidhur me propozimin për ndryshimet ligjore.

Ndërkohë *zonja Llagami* pyet sërish anëtarët nëse bien dakord që të bëhet një deklaratë për shtyp lidhur me qëndrimin për të inkurajuar gjyqtarët dhe të publikohet sot dhe në mënyrë shkresore të shkojë edhe propozimi Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimet ligjore.

Edhe *zonja Kadi* gjithashtu bie dakord me ato çka thanë kolegët dhe mendon që në deklaratë kjo gjë të thuhet dhe jo thjesht të vazhdojnë veprimet me Ministrinë e Drejtësisë, ashtu siç propozoi edhe Iliri edhe Fatmira me Marçelën. Pra duhet thënë në deklaratë ky ndryshimi i iniciativës ligjore sepse të bëhet si nxitje publike por të jetë edhe efektive dhe e besueshme, pasi kjo deklaratë po i drejtohet gjyqtarëve dhe që të jetë efektive, duhet që edhe ata të besojnë. Kështu që zonja Kadi sugjeroj që deklarata të mbajë edhe këtë pjesë.

*Zonja Shehu* e mbështet këtë mendim të zonjës Kadi, pasi pikërisht prandaj po bëhet kjo deklaratë, që të tregojë Këshilli qëndrimin dhe angazhimin lidhur me këtë situatë. Pra jo vetëm thirrja që ata të bëhen pjesë e Gjykatës Kushtetuese, por thirrja të këtë garancinë, përkushtimin e Këshillit për të punuar për ndryshimet ligjore për rikthimin e tyre në sistem. Kjo është dilema apo pengesa më e madhe që kanë shumë gjyqtarë për të aplikuar. Kështu që zonja Shehu është dakord që deklarata të shoqërohet me të gjithë deklaratën e Këshillit për të vijuar me ndryshimet ligjore.

Pasi të gjithë anëtarët e Këshillit bien dakord me qëndrimet e diskutuara më sipër, *zoti Muharremaj* do të hartojë një deklaratë, duke u shprehur gjithashtu edhe zoti Muharremaj mbi dakordësinë për nxitjen e gjyqtarëve për t'u angazhuar për të kandiduar

për plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën Kushtetuese por duke shprehur gjithashtu qenien e tij skeptik mbi efektin që do të ketë kjo deklaratë, në kushtet kur jo më larg se në mbledhjen e sotme u desh të rihapeshin thirrjet për plotësimin e vendeve vakante në sistemin gjyqësor.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**